



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2132 / Prot.
3

Tiranë, më 15 / 09 / 2021

VENDIM

Nr. 68 , datë 15.09.2021

“PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE DHE SHPALLJEN E AFATIT TË APLIKIMIT PËR ANËTARË NË BORDIN E ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËRFAQËSUES TË UNIVERSITETIT”

Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencorë në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 3, 48, e vijues, nenit 5, 19 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe sipas rendit të ditës, Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim dhe diskutoi mbi kriteret dhe afatet e aplikimet për anëtarë në Bordin e Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përfaqësues të universitetit,

VENDOSI:

1. Të shpallë thirrjen për aplikim për anëtarë në Bordin e Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përfaqësues të universitetit, sipas afateve dhe kriterëve në këtë vendim dhe të Formularit për Aplikim bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kriteret dhe dokumentet që duhet të plotësojnë aplikantët / kandidatët për anëtarë në Bordin e Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përfaqësues të universitetit si më poshtë.
3. Anëtarët përfaqësues të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në Bordin e Administrimit janë 3 (tri), nga të cilët 2 (dy) do të jenë nga Fakulteti i Mjekësisë dhe 1 (një) nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Kriteret:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi sipas përcaktimeve ligjore;
- Të mos jetë anëtar i Senatit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

- Të jetë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
- Të mos jetë autoritet drejtues (rektor, drejtues i njësisë kryesore (dekan), drejtues i njësisë bazë (shef departamenti), administrator);
- Të ketë minimalisht gradën shkencore “Doktor”;
- Të ketë integritet etik dhe profesional;
- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të ndryshuar;
- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*;
- Të mos kenë pengesa ligjore për të punuar në administratën shtetërore dhe konflikte interesi me funksionin e anëtarit të Bordit të Administrimit.

Dokumentet:

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar Njësia kryesore (fakulteti) për të cilën kandidon për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përfaqësues i universitetit;
 - Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (Curriculum Vitae);
 - Fotokopje e Gradës Shkencore / Titullit Akademik;
 - Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pasaportës;
 - Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, masës disiplinore sipas formatit të shtojcës nr. 1;
 - Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 2;
 - Formular deklarimi sipas ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të ndryshuar.
4. Afati i dorëzimit të dokumenteve për aplikim si kandidat për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përfaqësues i universitetit, do të jetë nga data 20.09.2021 deri më datë 01.10.2021, ora 14:00.
 5. Aplikimet do të kryhen në Sekretarinë e Senatit Akademik, në Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETARI
ARBEN GJATA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/2021

FLETË APLIKIMI

**PËR ANËTAR NË BORDIN E ADMINISTRIMIT NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËRFAQËSUES I UNIVERSITETIT**

Në zbatim të pikës 1 të nenit 48 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 50 të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, paraqes kandidaturën time për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përfaqësues i universitetit:

Unë i/e nënshkruara z/znj,

Emër: _____

Atësi: _____

Mbiemër: _____

Gjinia: _____

Titulli akademik /Grada shkencore: _____

Vendi i punës (fakulteti): _____

paraqes aplikimin tim për të qenë Kandidat për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si përfaqësues i Fakultetit të _____ dhe njëkohësisht përfaqësues i UMT-së, që do të votohen nga anëtarët e Senatit Akademik të UMT-së.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, deklaroj se:


- 1- Jam shtetas shqiptar dhe kam zotësi për të vepruar;
- 2- Jam personel me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
- 3- Nuk kam qenë dhe nuk jam i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- 4- Nuk kam shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” i ndryshuar, dhe ndaj personit tim nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

- 5- Nuk kam shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- 6- Nuk jam anëtarë i Senatit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
- 7- Nuk kam pengesa ligjore për të punuar në administratën shtetërore dhe konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit dhe me funksionin e anëtarit të Bordit të Administrimit;
- 8- Kam integritet etik dhe profesional.

Bashkëlidhur këtij formulari aplikimi:

- 1- Dokument identifikimi ID/Pasaportë (fotokopje);
- 2- Titulli Akademik / Grada Shkencore “ _____ ” i marrë me Vendimin Nr. _____, datë _____ nga KVTA / KPPPA dhe regjistruar në AKKSHI.
- 3- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (Curriculum Vitae);
- 4- Shtojca nr. 1 “Vetdeklarim mbi konfliktin e interesit dhe masës disiplinore” dhe nr. 2 “Vetdeklarim verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati”.

Emër, Mbiemer, Firma





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/2021

SHTOJCA NR. 1

VETDEKLARIM MBI KONFLIKTIN E INTERESIT DHE MASËS DISIPLINORE

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si përfaqësues i UMT-së, deklaroj se _____ pengesa ligjore për të punuar në administratën shtetërore dhe _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Gjithashtu deklaroj se _____ masë disiplinore në fuqi sipas përcaktimeve ligjore. Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 2

**VETDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË
PARAQITURA NGA KANDIDATI**

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtarë në Bordin e Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si përfaqësues i UMT-së, autorizoj Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime në këtë aplikim.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

Shënim: Këto deklarata janë pjesë e dokumenteve të aplikimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FORMULAR VETËDEKLARIMI

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

DATË: __/__/____

I. TË DHËNAT PERSONALE

A. Gjeneralitetet aktuale:

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	
VENDBANIM	
NR. ID	

B. Gjeneralitete të mëparshme:

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën veprë penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.)

(emër, mbiemër, nënshkrim)

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	

II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Unë, i/e nënshkruari /a _____ kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

- a) Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.
- b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën vepër penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.
- c) Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- ç) Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.
- d) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.
- e) Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

KUJDES: JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTJUI SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARI!

(emër, mbiemër, nënshkrim)

(emër, mbiemër, nënshkrim)

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. A jeni dënuar ndonjë herë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Gjykata	Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Masa e dënimit me burgim	Vepra penale për të cilën jeni dënuar	
			Neni	Lloji

2. A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë ?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar	Gjykata	Vepra penale për të cilën jeni dënuar		Vendimi përfundimtar/Dënimi
		Neni	Lloji	

3. A keni qenë ndonjë herë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet

4. A keni qenë ndonjëherë i ndaluar po arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale ?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet

5. A është caktuar ndaj jush ndonjë herë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

MASAT SHTRËNGUESETË SIGURISË	PËRGJIGJE	
	Aktualisht në fuqi	E revokuar
Ndalimi i daljes jashtë shtetit		
Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore		
Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar		
Garancia pasurore		
Arresti në shtëpi		
Arresti në burg		
Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik		

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Gjykata	Qyteti, shteti	Vepra penale për të cilën akuzoheshit		Vendimi përfundimtar	Periudha, data
		Neni	Lloji		

6. A është lëshuar ndonjë herë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Autoriteti urdhërues	Arsyeja	Qyteti, Shteti	Ekzekutimi (nëse është në fuqi apo jo)

7. A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj? (Me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj)

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja dëbimit	Periudha e dëbimit nga shteti i huaj	Të dhenat e aktit të dëbimit

8. A keni jetuar ndonjë herë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja	Periudha	Adresa e vendqendrimit

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Shënim: Në rast referimi të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të caktuara, bashkëngjitini një kopje të tyre këtij Formulari.

Nëse pjesë të caktuara të Formularit janë të pamjaftueshme për deklarin e të dhënave, shto aq pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.

(emër, mbiemër, nënshkrim)